



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS

Udhëzues Pune i Zyrës Administrative

Kod i Etikës Profesionale –

për Mbrojtësit dhe Prokurorët para Dhomave të Specializuara të Kosovës

Miratoi:	Administratorja, me miratimin e Kryetares së Dhomave të Specializuara të Kosovës
Data e miratimit:	1 mars 2019
Data e hyrjes në fuqi:	1 mars 2019
Zëvendëson:	Nuk ekziston
Numri:	KSC-BD-07

Tabela e Përmbajtjes

KREU I	Dispozita të përgjithshme	4
Neni 1	Qëllimi dhe fushëveprimi.....	4
Neni 2	Përkufizime.....	4
Neni 3	Interpretimi dhe zbatimimi i Kodit.....	6
Neni 4	Ndryshimet.....	6
Neni 5	Gjuha autentike dhe hyrja në fuqi.....	6
KREU II	Detyrimet e përgjithshme të mbrojtësve dhe prokurorëve	6
PJESA 1	DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	6
Neni 6	Standardet themelore profesionale	6
Neni 7	Sjellja diskriminuese.....	7
Neni 8	Shpërdorimi i kompetencave, shtrëngimi dhe ngacmimi	7
Neni 9	Ngacmimi seksual.....	8
PJESA 2	SINQERITETI NDAJ DHOMAVE TË SPECIALIZUARA	8
Neni 10	Sjellja gjatë procedurave gjyqësore	8
Neni 11	Komunikimi me gjykatësit dhe panelet	8
Neni 12	Konfidencialiteti.....	8
Neni 13	Komunikimi në mediat sociale, në shtyp dhe publik	9
PJESA 3	PROVAT DHE KOMUNIKIMET GJATË HETIMEVE DHE NDJEKJEVE PENALE	9
Neni 14	Provat.....	9
Neni 15	Komunikimi me persona të përfaqësuar	10
Neni 16	Komunikimi me persona të përfaqësuar nga mbrojtës	10
Neni 17	Komunikimi me dëshmitarët, viktimat dhe të tjerë.....	10
KREU III	Detyrimet e mbrojtësit	10
PJESA 1	PËRFAQËSIMI	10
Neni 18	Klientët e pritshëm dhe tarifat e rekomandimit	10
Neni 19	Refuzimi i përfaqësimit.....	11
Neni 20	Përlllogaritja e shpenzimeve ose honorarëve nga mbrojtësi i emëruar	11
Neni 21	Fillimi i përfaqësimit.....	11
Neni 22	Detyrimet e mbrojtësit në lidhje me përfaqësimin.....	12
Neni 23	Kohëzgjatja dhe përfundimi i përfaqësimit	12
PJESA 2	MARRËDHËNIA MBROJTËS-KLIENT	13
Neni 24	Gjatë përfaqësimit	13
Neni 25	Pas përfundimit të përfaqësimit	13
Neni 26	Konfidencialiteti i komunikimit mbrojtës-klient.....	14
Neni 27	Konfidencialiteti profesional.....	15
Neni 28	Konflikti i interesave.....	15
Neni 29	Marrëdhënie seksuale me klientët.....	16
KREU IV	Detyrimet e prokurorëve	16
Neni 30	Detyrime të përgjithshme.....	16
Neni 31	Pavarësia dhe paanësia	16
Neni 32	Konflikti i interesave.....	17
KREU V	Regjimi disiplinor	17

PJESA 1	DISPOZITA TË PËRGJITHSHME	17
<i>Neni 33</i>	<i>Kundërvajtjet dhe periudha e parashkrimit.....</i>	<i>17</i>
<i>Neni 34</i>	<i>Përgjegjësia e mbrojtësit ose prokurorit në pozitë eprore.....</i>	<i>17</i>
<i>Neni 35</i>	<i>Përgjegjësia e bashkëmbrojtësit ose prokurorit vartës</i>	<i>18</i>
<i>Neni 36</i>	<i>Procedura disiplinore për prokurorët</i>	<i>18</i>
PJESA 2	PROCEDURA DISIPLINORE	18
<i>Neni 37</i>	<i>Parashtrimi i ankesës.....</i>	<i>18</i>
<i>Neni 38</i>	<i>Të drejtat e palës së paditur.....</i>	<i>19</i>
<i>Neni 39</i>	<i>Komisioneri.....</i>	<i>19</i>
<i>Neni 40</i>	<i>Procedura para komisionerit</i>	<i>19</i>
<i>Neni 41</i>	<i>Komisioni disiplinor</i>	<i>20</i>
<i>Neni 42</i>	<i>Procedura para Komisionit Disiplinor.....</i>	<i>20</i>
<i>Neni 43</i>	<i>Masat disiplinore</i>	<i>21</i>
<i>Neni 44</i>	<i>Tërheqja e ankesës.....</i>	<i>22</i>
<i>Neni 45</i>	<i>Komisioni i Apelit Disiplinor</i>	<i>22</i>
<i>Neni 46</i>	<i>Procedura para Komisionit të Apelit Disiplinor.....</i>	<i>22</i>
<i>Neni 47</i>	<i>Vendim i formës së prerë.....</i>	<i>23</i>
PJESA 3	DISPOZITA PËRMBYLLËSE.....	23
<i>Neni 48</i>	<i>Marrëdhënia me regjime të tjera disiplinore.....</i>	<i>23</i>
<i>Neni 49</i>	<i>Dokumentimi i procedurave</i>	<i>24</i>

KREUI I Dispozita të përgjithshme

Neni 1 Qëllimi dhe fushëveprimi

- Në përputhje me nenin 34(3) të Ligjit për Dhomat e Specializuara dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar të Kosovës, Ligji nr. 05/L-053 ("Ligji"), dhe rregullën 23(3) të Rregullores së Procedurës dhe të Provave ("Rregullorja"), ky Kod është lëshuar nga Administratorja me miratimin e Kryetares, pas këshillimeve me gjykatësit, Prokurorin e Specializuar dhe përfaqësuesit e Mbrojtësve të Specializuar, me qëllim rregullimin e sjelljes profesionale në procedurat gjyqësore para Dhomave të Specializuara dhe çfarëdo aktiviteteve lidhur me to, si edhe për të siguruar integritetin e procedurave dhe administrimin e drejtë dhe të duhur të drejtësisë.
- Ky Kod, për aq sa përcaktohet, zbatohet për:
 - mbrojtësit dhe
 - prokurorët.Kur mbrojtësi nuk është as i emëruar, as i caktuar në përputhje me Direktivën për Mbrojtësit ("Direktiva"), dispozitat e këtij Kodi zbatohen vetëm në kuadër të aktiviteteve të mbrojtësit në lidhje me Dhomat e Specializuara.
- Pavarësisht nga cilado dispozitë e këtij Kodi, rregulla 61(1) e Rregullores, zbatohet në çdo kohë për çdo person që paraqitet para Dhomave të Specializuara.

Neni 2 Përkufizime

- Përveçse kur përcaktohet ndryshe në paragrafin 2, termat e përdorura më poshtë kanë kuptimin që u jep Ligji, rregulla 2 e Rregullores dhe pjesa 2 e Direktivës për Mbrojtësit. Njëjesi përfshin shumësin dhe anasjelltas.
- Gjithashtu zbatohen edhe përkufizimet e mëposhtme:

Mbrojtës i emëruar	Mbrojtësi i emëruar nga Administratori sipas pjesëve 12 dhe 13 të Direktivës;
Zyrtar i emëruar	Çdo zyrtar i Dhomave të Specializuara ose i Zyrës së Prokurorit të Specializuar, i emëruar nga Autoriteti Emërues në përputhje me Ligjin;
Mbrojtës i caktuar	Mbrojtësi i caktuar nga Administratori sipas pjesëve 12, 14, 17 të Direktivës dhe në përputhje me Rregulloren e Ndhmës Juridike;
Klient	Një i dyshuar, i akuzuar, dëshmitar, anëtar i një grupi të cilit i caktohet mbrojtës viktimash sipas rregullës 113 të Rregullores, dhe çdo person tjetër që ka të drejtën e përfaqësimit juridik sipas Ligjit, Rregullores, ose një urdhri të panelit, për të cilin është emëruar ose caktuar një mbrojtës në përputhje me Direktivën;

Parashtrues i ankesës	Një gjykatës, punonjës, praktikant, konsulent, palë apo pjesëmarrës aktual apo i mëparshëm në procedurat para Dhomave të Specializuara, Administratori apo çdo person tjetër, të drejtat apo interesat e të cilit janë prekur në mënyrë të konsiderueshme nga një sjellje kundërvajtëse e pretenduar në përputhje me nenin 33, dhe i cili paraqet një ankesë në përputhje me nenin 37;
Mbrojtës	Mbrojtësi sikurse përcaktohet në pjesën 2 të Direktivës, duke përfshirë bashkëmbrojtësin;
Prokurorët	Prokurorët e Zyrës së Prokurorit të Specializuar, të emëruar sipas nenit 35(9), të Ligjit;
Zyra Administrative	Organi i Dhomave të Specializuara, sikurse përmendet në nenin 34 të Ligjit;
Raport	Një vlerësim i komisionerit për rezultatet e hetimit të sjelljes kundërvajtëse të pretenduar, në përputhje me nenin 40;
Pala e paditur	Mbrojtësi, ose prokurori ndaj të cilit është bërë një ankesë në përputhje me nenin 37;
Rregullorja për Punonjësit	Rregullorja për Punonjësit e Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar;
Ekip	Personeli mbështetës i mbrojtësit të emëruar ose të caktuar, siç përmendet në pjesën 18 të Direktivës, përfshirë bashkëmbrojtësit, ndihmësit juridikë, konsulentët dhe çdo person tjetër marrë në shërbim nga mbrojtësi i emëruar apo i caktuar dhe që punon nën mbikëqyrjen e tij;

Neni 3 Interpretimi dhe zbatimi i Kodit

1. Ky Kod interpretohet dhe zbatohet në përputhje me Kushtetutën, Ligjin dhe Rregulloren, dispozitat e të cilave kanë përparësi në rast të ndonjë mospërputhjeje me këtë Kod.
2. Në rast konflikti midis këtij Kodi dhe cilitdo kodi tjetër të punës apo etikës, të cilin mbrojtësit apo prokurorët janë të detyruar ta respektojnë, ky Kod ka përparësi në lidhje me sjelljen e tyre para Dhomave të Specializuara. Për rregullimin e sjelljes profesionale të prokurorëve para Dhomave të Specializuara, ky Kod ka përparësi kundrejt “Kodit të Etikës së Punonjësve të Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar të Kosovës, sipas rregullës 5 të Rregullores për Punonjësit”.
3. Për llogaritjen dhe ndryshimin e afateve sipas këtij Kodi, rregulla 9 e Rregullores zbatohet *mutatis mutandis*.

Neni 4 Ndryshimet

1. Me miratimin e Kryetarit, Administratori mund ta ndryshojë këtë Kod *proprio motu*, ose në bazë të një propozimi për ndryshim sipas rregullës 23(3) të Rregullores. Administratorit mund t’i paraqiten propozime të arsyetuara për ndryshime nga Kryetari, në këshillim me gjykatësit, varësisht prej rrethanave, nga Organi i Pavarur Përfaqësues i Mbrojtësve të Specializuar, si edhe nga Prokurori i Specializuar. Administratori gjithashtu mund të këshillohet edhe me Prokurorin e Specializuar dhe me Organin Përfaqësues të Pavarur të Mbrojtësve të Specializuar, sipas rastit, në lidhje me një propozim për ndryshim.
2. Administratori e dokumenton procedurën e ndryshimit duke i informuar parashtruesit e propozimeve për ndryshime në lidhje me vendimin. Sipas rrethanave, Administratori mund ta bëjë publike procedurën e ndryshimit, apo pjesë të saj.
3. Ndryshimet nuk kanë fuqi prapavepruese dhe nuk janë të zbatueshme në asnjë çështje në shqyrtim e sipër në dëm të mbrojtësve, klientëve të tyre apo prokurorëve.

Neni 5 Gjuha autentike dhe hyrja në fuqi

1. Gjuha autentike e këtij Kodi është anglishtja.
2. Ky Kod dhe çdo ndryshim i tij hyjnë në fuqi në ditën e publikimit.

KREU II Detyrimet e përgjithshme të mbrojtësve dhe prokurorëve

Pjesa 1 Dispozita të përgjithshme

Neni 6 Standardet themelore profesionale

1. Në kuadër të roleve të tyre përkatëse në procedura, mbrojtësit dhe prokurorët:
 - a. ushtrojnë detyrat e tyre me ndershmëri dhe në mënyrë të pavarur;

- b. respektojnë fshehtësinë dhe konfidencialitetin profesional;
 - c. veprojnë me zell, dinjitet dhe integritet në kryerjen e detyrave të tyre dhe sillen me respekt ndaj çdokujt me të drejtë pjesëmarrjeje në procedurë;
 - d. veprojnë brenda kornizës ligjore dhe në përputhje me të dhe me çdo vendim apo urdhër të një paneli;
 - e. veprojnë në përputhje me parimet e gjykimit të drejtë dhe standardet e të drejtave të njeriut;
 - f. ndërmarrin të gjitha hapat e arsyeshëm për të siguruar se veprimet e tyre nuk dëmtojnë ose diskreditojnë procedurat para Dhomave të Specializuara;
 - g. u përmbahen standardeve më të larta të etikës profesionale në përgatitjen dhe paraqitjen e çështjes;
 - h. ndërmarrin të gjitha hapat e arsyeshëm për përmbushjen e detyrimeve të tyre nëpërmjet zotërimit të njohurive dhe kompetencës profesionale të nevojshme në të drejtën dhe procedurën e zbatueshme para Dhomave të Specializuara;
 - i. ndërmarrin të gjitha hapat e arsyeshëm për të mundësuar zhvillimin e tyre të vazhdueshëm profesional, duke përfshirë informimin mbi zhvillimet përkatëse të drejtësisë dhe jurisprudencës; dhe
 - j. i kushtojnë kohën dhe mjetet e nevojshme përmbushjes në kohë dhe me efikasitet të përgjegjësive të tyre.
2. Mbrojtësit dhe prokurorët nuk veprojnë në rolet e tyre përkatëse në procedura ku ka të ngjarë të paraqiten si dëshmitarë, përveçse kur dëshmia e tyre lidhet me:
- k. një çështje të pakontestuar; ose
 - l. natyrën dhe vlerën e shërbimeve juridike të ofruara në atë çështje.

Neni 7 Sjellja diskriminuese

Mbrojtësit dhe prokurorët nuk kryejnë sjellje diskriminuese për arsye të përkatësisë racore, gjinore, besimit fetar, shtetësisë, prejardhjes etnike, orientimit seksual, aftësive të kufizuara, moshës, gjuhës, prejardhjes shoqërore apo çdo statusi tjetër.

Neni 8 Shpërdorimi i kompetencave, shtrëngimi dhe ngacmimi

1. Ndaj klientëve nëse kanë, anëtarëve të ekipit të tyre, punonjësve apo zyrtarëve të emëruar të Dhomave të Specializuara dhe Zyrës së Prokurorit të Specializuar, praktikantëve, konsulentëve, apo personave të tjerë të cilët ndihmojnë apo marrin pjesë në procedura, mbrojtësit dhe prokurorët nuk sillen e as veprojnë, drejtpërdrejt apo tërthorazi në ndonjë mënyrë që përbën:

- a. shpërdorim të kompetencave dhe pozitës; ose
- b. shtrëngim, frikësim, apo ushtrim të çfarëdo ndikimi tjetër të palejueshëm, apo çfarëdo forme ngacmimi.

2. Në kuadër të këtij Kodi, “ngacmimi” nënkupton çdo sjellje të papërshtatshme dhe të padëshirueshme që logjikisht mund të pritët ose të perceptohet se i shkakton fyerje apo poshtërim një personi tjetër, duke përfshirë, ndër të tjera, përmes fjalëve, gjesteve apo veprimeve që mund të irritojnë, alarmojnë, keqpërdorin, përuhin, fyejnë, frikësojnë, nënvlerësojnë, poshtërojnë, apo turpërojnë dikë tjetër, apo që krijojnë një mjedis pune frikësues, armiqësor apo fyes. Krahas këtyre, “ngacmimi” mund të përfshijë:

- a. trajtimin e dikujt në mënyrë më pak të favorshme për shkak se ai person ka kundërshtuar, ose i është nënshtruar një sjelljeje të përcaktuar në nenin 7 apo nenin 9; dhe

- b. përdorimin e kundërshtimit apo nënshtrimit ndaj një sjelljeje sipas nenit 7 ose nenit 9, si:
- (1) kusht apo kriter për punësimin e një personi;
 - (2) bazë për vendime punësimi që ndikojnë në punësimin apo ngritjen në detyrë të një personi; apo
 - (3) bazë për të cenuar kryerjen e punës prej një personi.

Neni 9 Ngacmimi seksual

1. Mbrojtësit dhe prokurorët nuk kryejnë ngacmim seksual të drejtpërdrejtë ose të tërthortë ndaj klientëve të tyre, nëse kanë, ndaj anëtarëve të ekipit të tyre, punonjësve ose zyrtarëve të emëruar të Dhomave të Specializuara dhe të Zyrës së Prokurorit të Specializuar të Kosovës, praktikantëve, konsulentëve, apo ndaj personave që ndihmojnë ose marrin pjesë në procedura.
2. Në kuadër të këtij Kodi, “ngacmimi seksual” nënkupton çdo afrim të padëshirueshëm seksual, kërkesë për favore seksuale, sjellje apo gjest gojor apo fizik të natyrës seksuale, apo çdo sjellje tjetër të natyrës seksuale që logjikisht mund të pritet ose të perceptohet se i shkakton fyerje apo poshtërim një personi tjetër, kur një sjellje e tillë cenon punën, bëhet kusht për punësim, apo krijon një mjedis pune frikësues, armiqësor apo fyes.

Pjesa 2 Singëriteti ndaj Dhomave të Specializuara

Neni 10 Sjellja gjatë procedurave gjyqësore

Mbrojtësit dhe prokurorët:

- a. sillen me respektin e duhur ndaj paneleve;
- b. veprojnë në kohë dhe mënyrë efikase, ndër të tjera duke iu përgjigjur pa vonesa të panevojshme çdo vendimi ose urdhri të një paneli dhe u përgjigjen në kohë mocioneve të palëve të tjera;
- b. nuk bëjnë në mënyrë të vetëdijshme paraqitje të pasakta të fakteve materiale ose të ligjit para Dhomave të Specializuara dhe;
- c. nuk i japin panelit informacion të gabuar në mënyrë të vetëdijshme.

Ata ndërmarrin të gjitha hapat e arsyeshëm për të korigjuar paraqitjen e pasaktë të fakteve materiale ose të ligjit, menjëherë pasi të jenë vetëdijësuar për gabimin.

Neni 11 Komunikimi me gjykatësit dhe panelet

Përveçse kur lejohet nga Rregullorja, nga ky Kod, ose nga paneli që merret me çështjen, mbrojtësit dhe prokurorët nuk duhet:

- a. të kontaktojnë një panel, apo një gjykatës të atij paneli në lidhje me themelësinë e një çështjeje të caktuar, përveçse në kontekst të procedurave, sipas rastit; ose
- b. t'i dërgojnë prova, shënime apo dokumente një paneli apo një gjykatësi të atij paneli, përveçse përmes Zyrës Administrative, ose në raste të ngutshme, në të njëjtën kohë që i dorëzohen edhe Zyrës Administrative.

Neni 12 Konfidencialiteti

1. Mbrojtësit dhe prokurorët respektojnë dhe tregojnë të gjithë kujdesin e duhur për të mbrojtur konfidencialitetin e informacionit në përputhje me Ligjin, Rregulloren, Direktivën, këtë Kod, çdo dispozitë tjetër të zbatueshme, si edhe me vendimet ose urdhrat e një paneli.
2. Mbrojtësit dhe prokurorët nuk nxjerrin asnjë informacion me status konfidencial apo rreptësisht konfidencial sipas rregullës 82 të Rregullores, duke përfshirë identitetin e viktimave dhe dëshmitarëve të mbrojtur, si edhe çdo informacion konfidencial që mund të zbulojë identitetin dhe vendndodhjen e tyre, përveçse kur autorizohen shprehimisht nga paneli për këtë.
3. Detyrimet përcaktuar në paragrafët 1 dhe 2 mbeten në fuqi edhe pas përfundimit të detyrave të mbrojtësit.
4. Mbrojtësit dhe prokurorët mund t'u tregojnë anëtarëve të ekipit të tyre, apo personave nën vartësinë e tyre informacion të mbrojtur në përputhje me paragrafin 1 dhe 2, vetëm për t'iu mundësuar atyre kryerjen e detyrave. Mbrojtësit dhe prokurorët të cilët nxjerrin informacion konfidencial në përputhje me këtë paragraf, garantojnë se personat që marrin një informacion të tillë janë në dijeni të rregullave përkatëse të konfidencialitetit dhe kanë detyrimin e respektimit të tyre.

Neni 13 Komunikimi në mediat sociale, në shtyp dhe publik

Mbrojtësit dhe prokurorët nuk duhet që me vetëdije:

- a. të bëjnë në media sociale, shtyp apo publikisht deklarata të rreme apo shpifëse, apo të nxjerrin informacion konfidencial, ndër të cilat informacione për persona të përfshirë në procedura; ose
- b. të publikojnë apo të ndihmojnë në publikimin e materialeve në lidhje me procedurat para Dhomave të Specializuara, të cilat:
 - i. janë të rreme apo shpifëse, apo zbulojnë informacione konfidenciale, ndër të cilat informacione për persona të përfshirë në procedura;
 - ii. që dëmtojnë, apo ka gjasa të dëmtojnë procedurat; ose
 - iii. që diskreditojnë apo ka gjasa të diskreditojnë procedurat.

Pjesa 3 Provat dhe komunikimet gjatë hetimeve dhe ndjekjeve penale

Neni 14 Provat

1. Mbrojtësit dhe prokurorët në çdo kohë ruajnë paprekshmërinë e të gjitha provave. Nëse gjatë mbledhjes së provave, mbrojtësit, sipas rastit dhe prokurorët kanë arsye të besojnë se provat e zbuluara mund të asgjësohen apo të ndryshohen, ata i kërkojnë panelit të sigurojë mbrojtjen e provave në përputhje me Rregulloren.
2. Mbrojtësit dhe prokurorët përmbushin me përpikëri detyrimet përkatëse të tyre për nxjerrje materiale, në përputhje me Ligjin dhe Rregulloren.
3. Mbrojtësit dhe prokurorët nuk paraqesin prova mbi bazën e vërtetësisë së brendisë së tyre kur:
 - a. e dinë se janë të rreme; ose
 - b. kanë arsye të besojnë se janë siguruar me anë të metodave të paligjshme, përveçse kur e njoftojnë panelin për këtë gjë.
4. Mbrojtësit dhe prokurorët nuk lejojnë me vetëdije dhënien e dëshmime të rreme, as nuk mbështeten në to.

5. Në lidhje me shkelje të detyrimeve të këtij neni, procedura disiplinore mund të fillojë vetëm pas komunikimit nga paneli sipas rregullës 63(2) të Rregullores.

Neni 15 Komunikimi me persona të papërfaqësuar

1. Për aq sa është e nevojshme dhe në interes të roleve të tyre përkatëse, mbrojtësit dhe prokurorët mund të komunikojnë dhe takohen me një person të papërfaqësuar, duke treguar kujdesin e nevojshëm sikurse përcaktohet më poshtë.
2. Kur mbrojtësit apo prokurorët kontaktojnë persona të papërfaqësuar:
 - a. sipas rrethanave, i informojnë këta persona mbi të drejtën e tyre për ndihmë prej një mbrojtësi dhe në qoftë se ata nuk kanë mjete për të paguar mbrojtësin, mbi të drejtën e tyre për të kërkuar caktimin e një mbrojtësi sipas Direktivës dhe;
 - b. pa shkelur konfidencialitetin e komunikimit mbrojtës-klient apo rregulla të tjera të konfidencialitetit, i informojnë këta persona për interesat e përfaqësuar nga mbrojtësit apo prokurorët, sipas rastit, dhe për qëllimin e komunikimit.
3. Kur gjatë një komunikimi apo një takimi me një person të papërfaqësuar mbrojtësit dhe prokurorët bëhen të vetëdijshëm për konflikt të mundshëm interesi, ata e ndërpresin menjëherë komunikimin dhe kontaktin me atë person.

Neni 16 Komunikimi me persona të përfaqësuar nga mbrojtës

Mbrojtësit dhe prokurorët nuk komunikojnë me klientin e një mbrojtësi, përveçse përmes apo me lejen e atij mbrojtësi, me lejen e panelit ose kur komunikimi është nisur nga klienti.

Neni 17 Komunikimi me dëshmitarët, viktimat dhe të tjerë

1. Mbrojtësit dhe prokurorët nuk frikësojnë apo ngacmojnë dëshmitarët apo viktimat, as i vënë nën tryzni që logjikisht nuk përlijet nga përmbushja efikase e përgjegjësive të mbrojtësve ose të prokurorëve. Ata tregojnë kujdes të veçantë për viktimat e dhunës fizike, psikologjike apo seksuale, për të miturit, të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara.
2. Në lidhje me dëshmitarët, viktimat dhe persona të tjerë që komunikojnë me Dhomat e Specializuara apo Zyrën e Prokurorit të Specializuar, mbrojtësit dhe prokurorët nuk angazhohen në marrëdhënie të cilat do të mund të cenonin integritetin e Dhomave të Specializuara ose Zyrës së Prokurorit të Specializuar.

KREU III Detyrimet e mbrojtësit

Pjesa 1 Përfaqësimi

Neni 18 Klientët e pritshëm dhe tarifat e rekomandimit

1. Mbrojtësi nuk kontakton një klient të pritshëm, të afërmit apo të njohurit e tij, drejtpërdrejt apo tërthorazi, në përpjekje për të marrë punë, përveçse kur persona të tillë i kanë bërë të ditur mbrojtësit dëshirën e tyre për t'u kontaktuar prej tij.
2. Mbrojtësi nuk i jep informacion të rremë, çorientues, apo mashtrues një klienti të pritshëm, apo të afërmit apo të njohurve të tij në lidhje me shërbimet juridike që i propozon.
3. Mbrojtësi nuk kërkon, e as pranon nga një mbrojtës apo nga një person tjetër honorar, komision apo çfarëdo përfitimi tjetër për referimin apo rekomandimin e atij mbrojtësi tek një klient. Mbrojtësi nuk i paguan askujt honorar, komision apo ndonjë kompensim tjetër për rekomandimin e një klienti te një mbrojtës.
4. Kur tashmë përfaqëson një klient para Dhomave të Specializuara, mbrojtësi konsultohet me atë klient përpara se t'i japë këshilla apo ndihmë një të pandehuri tjetër para Dhomave të Specializuara, apo të fillojë bisedimet me një klient të pritshëm.

Neni 19 Refuzimi i përfaqësimit

1. Mbrojtësi mund të refuzojë të përfaqësojë një klient të pritshëm pa dhënë arsye. Mbrojtësi refuzon përfaqësimin e një klienti të pritshëm kur:
 - a. ekziston konflikt interesi sipas nenit 28;
 - b. nuk lejohet ta përfaqësojë për arsye të këtij Kodi;
 - c. ka pasur marrëdhënie seksuale me klientin e pritshëm, nëse një marrëdhënie seksuale e tillë logjikisht mund të pritet të rezultojë në shkelje të këtij Kodi; ose
 - d. nuk është në gjendje ta trajtojë çështjen me përkushtim, përfshirë rrethanat kur nuk është në gjendje t'i kushtojë kohën e nevojshme përfaqësimit të një klient të pritshëm.
2. Mbrojtësi e njofton pa vonesë klientin e pritshëm se refuzon ta përfaqësojë.

Neni 20 Përllogaritja e shpenzimeve ose honorarëve nga mbrojtësi i emëruar

1. Përpara paraqitjes së një kërkesë për emërim sipas pjesës 12(1)(a) dhe 13 të Direktivës për Mbrojtësit, mbrojtësi i sqaron klientit të pritshëm honorarët dhe shpenzimet e mundshme për klientin, duke i treguar:
 - a. bazën e llogaritjes së honorarëve dhe çdo shpenzimi tjetër dhe;
 - b. mënyrën e pagesës.Nëse klienti i pritshëm pajtohet me përllogaritjen e honorarëve, mbrojtësi lidh një marrëveshje përfaqësimi me shkrim me atë klient e cila përfshin honorarët dhe të drejtën e klientit për të marrë fatura të detajuara të honorarëve të përfaqësimit dhe çdo shpenzimi tjetër.
Mbrojtësi i emëruar:
 - a. nuk i përcakton honorarët në varësi të rezultatit të çështjes, ose
 - b. nuk pranon kompensim për përfaqësimin e një klienti nga asnjë burim tjetër veç klientit, përveçse kur:
 - (1) klienti jep pëlqimin e vet me shkrim; dhe
 - (2) nuk ka asnjë cenim të pavarësisë së mbrojtësit, gjykimin profesional të mbrojtësit, apo të marrëdhënies mbrojtës-klient.

Neni 21 Fillimi i përfaqësimit

Përfaqësimi i një klienti para Dhomave të Specializuara nga mbrojtësi fillon me emërimin apo caktimin e mbrojtësit nga Administratori, përfshirë edhe si mbrojtës kujdestar, në përputhje me Direktivën dhe Rregulloren e Ndhmës Juridike, sipas rastit.

Neni 22 Detyrimet e mbrojtësit në lidhje me përfaqësimin

1. Mbrojtësi nuk mund:
 - a. të përziejë fondet apo kapitalet e një klienti me të vetat, apo me fondet apo kapitalet e punëdhënësit, bashkëpunëtorëve apo firmës juridike të mbrojtësit;
 - b. të mbajë fondet apo kapitalet e marra në emër të një klienti, me përjashtim të fondeve që përfaqësojnë pagesën e ligjshme të një honorari apo të shpenzimeve për shërbimet;
 - c. të huazojë fonde apo kapitale nga një klient.
2. Mbrojtësi bën sigurimin për përgjegjësinë civile profesionale të vet në një masë të arsyeshme, duke marrë parasysh natyrën dhe gjasën e rreziqeve të mundshme të përfshira.
3. Mbrojtësi llogarit në mirëbesim kohën e shpenzuar duke punuar për një çështje dhe mban e ruan evidencë të hollësishme rreth kohës së shpenzuar.
4. Mbrojtësi kryen në çdo kohë detyrën e përfaqësimit në mënyrë efikase dhe në më të mirën për klientin.
5. Mbrojtësi e informon klientin për detyrimet etike të mbrojtësit sipas këtij Kreu, në fillim të përfaqësimit dhe sa herë që kërkohet gjatë përfaqësimit.

Neni 23 Kohëzgjatja dhe përfundimi i përfaqësimit

1. Mbrojtësi e këshillon dhe përfaqëson klientin për kohëzgjatjen e përcaktuar në vendimin e emërimit apo caktimit, sipas rastit, apo ndryshe deri në përfundimin e përfaqësimit, në përputhje me pjesën 16 të Direktivës.
2. Në përputhje me pjesën 16(2)(b) të Direktivës, mbrojtësi:
 - a. mund të kërkojë përfundimin e përfaqësimit, sidomos kur:
 - (1) klienti i ka shfrytëzuar apo është orvatur të shfrytëzojë shërbimet e mbrojtësit për kryerjen e një krimi ose mashtrimi, apo duke i shfrytëzuar shërbimet e mbrojtësit, vazhdon të veprojë në një mënyrë të cilën logjikisht mbrojtësi e gjykon të neveritshme, të paarsyeshme, kriminale, mashtruese, apo çorientuese; apo
 - (2) klienti nuk përmbush një detyrim ndaj mbrojtësit në lidhje me shërbimet e mbrojtësit dhe i është dhënë paralajmërim i arsyeshëm se mbrojtësi do të kërkojë përfundimin e përfaqësimit nëse detyrimi nuk përmbushet; ose
 - b. kërkon përfundimin nëse:

- (1) një detyrim i përcaktuar në këtë Kod e dikton këtë përfundim;
- (2) gjendja e vet fizike ose mendore pengon thelbësisht aftësinë për përfaqësimin e klientit;
- (3) vazhdimi i përfaqësimit pashmangshmërisht do të kishte për pasojë një shkelje të rëndë të detyrimeve të tij sipas këtij Kodi; ose,
- (4) është mbrojtës i emëruar dhe hiqet nga klienti i vet, veprim që i nënshtrohet shqyrtimit nga një panel apo një gjykatës i caktuar për këtë qëllim, në përputhje me pjesën 16(1) të Direktivës.

Pjesa 2 Marrëdhënia mbrojtës-klient

Neni 24 Gjatë përfaqësimit

1. Gjatë kryerjes së detyrave të veta, mbrojtësi:
 - a. përfaqëson klientin në mënyrë efikase dhe efektive, me qëllim shmangien e shpenzimeve apo vonesave të panevojshme të procedurave;
 - b. mbron më së miri interesat e klientit dhe vepron në përputhje me to;
 - c. përfundon të gjitha çështjet e marra përsipër në emër të klientit brenda fushëveprimit të përfaqësimit juridik, sipas nenit 23(1);
 - d. në marrëdhëniet me klientin, merr parasysh rrethanat personale dhe nevojat konkrete të klientit, në veçanti në përfaqësimin e personave të cenueshëm;
 - e. mban klientin të informuar për statusin e çështjes që shqyrtohet prej Dhomave të Specializuara në të cilën klienti është palë e interesuar dhe përmbush pa vonesë të gjitha kërkesat e arsyeshme për informacion, duke respektuar detyrimet e konfidencialitetit; dhe
 - f. gjatë komunikimit me klientin, ndërmerr të gjitha hapat e arsyeshëm për të siguruar konfidencialitetin e një komunikimi të tillë.
2. Mbrojtësi këshillohet me klientin në lidhje me objektivat e përfaqësimit dhe mjetet me të cilat do të realizohen këto objektiva. Mbrojtësi i jep klientit të gjitha shpjegimet dhe informacionin që logjikisht nevojiten për marrjen e vendimeve të bazuara në informacion në lidhje me përfaqësimin e tij. Mbrojtësi respekton vendimet e klientit për objektivat e përfaqësimit dhe mjetet me të cilat do të realizohen këto objektiva, për sa kohë që ato janë në përputhje me detyrat e mbrojtësit sipas Ligjit, Rregullores, Direktivës, këtij Kodi, apo vendimeve ose urdhrave të një paneli.
3. Mbrojtësi nuk e këshillon apo ndihmon klientin të përfshihet në veprime që mbrojtësi e di se janë kriminale apo mashtruese, në shkelje të Ligjit, Rregullores, Direktivës, këtij Kodi, apo vendimit ose urdhrat të një paneli. Mbrojtësi mund t'i diskutojë me klientin pasojat ligjore të një mënyre të propozuar veprimi dhe mund ta këshillojë apo ndihmojë klientin me mirëbesim për të përcaktuar vlefshmërinë, fushëveprimin apo kuptimin e dispozitave ligjore të zbatueshme.
4. Pavarësisht nga neni 26(1), kur mbrojtësi ka arsye të besojë se aftësia e klientit për të marrë vendime të menduara si duhet në lidhje me përfaqësimin është e kufizuar për shkak të paaftësisë mendore, statusit prej të mituri, apo për ndonjë arsye tjetër, mbrojtësi e informon Administratorin ose, sipas rastit, panelin përkatës për këtë dhe ndërmerr hapat e nevojshëm për të siguruar vazhdimin e përfaqësimit në më të mirën e atij klienti.

Neni 25 Pas përfundimit të përfaqësimit

1. Detyrat e mbrojtësit vijnë deri në përfundimin e përfaqësimit, përveç detyrave që vijnë edhe më pas sipas këtij Kodi, Direktivës, apo Rregullores së Ndhmës Juridike.
2. Pas përfundimit, mbrojtësi i kalon sa më shpejt që të jetë e mundur klientit të mëparshëm dhe mbrojtësit zëvendësues të gjithë letërkëmbimin që mbrojtësi ka marrë apo vazhdon të marrë lidhur me përfaqësimin, pa cenuar detyrat që vijnë edhe pas përfundimit të përfaqësimit.
3. Në rast përfundimi të parakohshëm të përfaqësimit sipas pjesës 16 të Direktivës:
 - a. detyrat e Mbrojtësit në përputhje me këtë Kod vazhdojnë derisa mbrojtësi të mund të zëvendësohet apo për një periudhë kur janë njëkohësisht dy mbrojtës, sipas pjesës 16(4) të Direktivës;
 - b. mbrojtësi që zëvendësohet ndërmerr të gjitha hapat e arsyeshëm për të mbrojtur interesat e klientit dhe përgatit një dokument përcjellës për transferimin e dosjes së çështjes, duke përkrahur me hollësitë e duhura:
 - (1) një përmbledhje të pikave përkatëse ligjore dhe të fakteve të çështjes;
 - (2) teorinë e çështjes dhe çdo aspekt tjetër strategjik përkatës;
 - (3) udhëzimet e klientit për objektivat dhe mjetet me të cilat duhen realizuar objektivat, në përputhje me nenin 24;
 - (4) një përshkrim të përgjithshëm të strukturës së dosjes së çështjes; dhe
 - (5) punën në vijim dhe afatet.
4. Pas një periudhe pesëvjeçare dhe pasi njofton klientin, nëse është e mundshme, mbrojtësi mund të asgjësojë në mënyrë të sigurt dosjet që bëjnë pjesë në konfidencialitetin e komunikimit mbrojtës-klient dhe ia kthen dokumentet e tjera gjyqësore Administratorit apo, në rast se ekziston një marrëveshje e pranuar, mekanizmit përmblyllës përkatës.

Neni 26 Konfidencialiteti i komunikimit mbrojtës-klient

1. Pavarësisht nëse vazhdon ta përfaqësojë klientin, ose jo, mbrojtësi ruan konfidencialitetin e çështjes së klientit dhe nuk ia bën të ditur asnjë personi tjetër përveç ekipit të mbrojtësit që i nevojitet ai informacion për kryerjen e detyrave, informacion që i është dhënë në mirëbesim dhe nuk e shfrytëzon një informacion të tillë në dëm të klientit, apo për përfitimin e vet apo të një personi tjetër.
2. Pavarësisht nga paragrafi 1, mbrojtësi mund t'ia bëjë të ditur një pale të tretë informacionin që i është besuar në mënyrë konfidenciale kur:
 - a. klienti është konsultuar plotësisht dhe ka dhënë pëlqimin me vetëdije;
 - b. me dëshirën e vet, klienti ia ka bërë të ditur përmbajtjen e komunikimit një pale të tretë dhe pala e tretë dëshmon për dhënien e këtij informacioni;
 - c. është thelbësore të provohet një pretendim i bërë në emër të mbrojtësit në përputhje me nenin 24(4) se aftësia e klientit për të marrë vendime të menduara si duhet në lidhje me përfaqësimin është e kufizuar për shkak të paaftësisë mendore, statusit prej të mituri, apo për ndonjë arsye tjetër;
 - d. është thelbësore të provohet një pretendim apo mbrojtje në emër të mbrojtësit në një mosmarrëveshje midis mbrojtësit dhe klientit; të provohet mbrojtja ndaj akuzave penale apo disiplinore apo në çdo pretendim të ngritur zyrtarisht kundër mbrojtësit, bazuar në veprime në të cilat është përfshirë klienti; ose në përgjigje të akuzave në çdo proces që ka të bëjë me përfaqësimin e klientit nga mbrojtësi;

- e. është thelbësore të respektohet një urdhër i dhënë nga një gjykatës apo panel; ose
- f. është thelbësore të parandalohet një veprim që mbrojtësi ka arsye të besojë se:
 - (1) është apo mund të jetë kriminal në territorin në të cilin mund të ndodhë, apo sipas Ligjit apo Rregullores; ose,
 - (2) mund të rezultojë në vdekje apo dëmtim të konsiderueshëm fizik të një personi, nëse informacioni nuk bëhet i ditur.

Neni 27 Konfidencialiteti profesional

Çdo letërkëmbim profesional midis dy apo më shumë mbrojtësish është konfidencial, përveç rasteve të përjashtimeve që deklarohen qartë që në fillim, apo për të cilat palët pajtohen më pas.

Neni 28 Konflikti i interesave

1. Mbrojtësi ka detyrë të jetë besnik ndaj klientit të vet. Mbrojtësi gjithashtu ka detyrim ndaj Dhomave të Specializuara që të veprojë në mënyrë të pavarur në interes të drejtësisë dhe këto interesa t'i vendosë para interesave të veta, apo të ndonjë personi, organizate apo shteti tjetër.
2. Mbrojtësi tregon të gjithë kujdesin e arsyeshëm që të mos krijohet asnjë konflikt interesash.
3. Mbrojtësi nuk këshillon, përfaqëson apo vepron në emër të një klienti në një çështje para Dhomave të Specializuara nëse:
 - a. është duke këshilluar, përfaqësuar apo vepruar në emër të një klienti tjetër në të njëjtën çështje para Dhomave të Specializuara;
 - b. mbrojtësi apo firma e vet ka këshilluar, përfaqësuar një klient të mëparshëm, apo ka vepruar në emër të një klienti të mëparshëm ose interesat e klientit të pritshëm, ose të ri janë thelbësisht të kundërta me interesat të klientit të mëparshëm;
 - c. ka marrë pjesë personalisht dhe thelbësisht në atë çështje si zyrtar i emëruar, punonjës, apo në ndonjë cilësi tjetër në Dhomat e Specializuara, Zyrën e Prokurorit të Specializuar, apo në TFHS (Task Forca Hetimore Speciale); apo
 - d. gjykimi profesional i të cilit në emër të klientit logjikisht pritet se do të ndikohet negativisht nga përgjegjësia apo interesat e mbrojtësit në lidhje me një palë të tretë, ose nga interesa financiare, të biznesit, pronësore ose vetjake.
4. Kur lind një konflikt i mundshëm interesash sipas paragrafit 3, në çdo fazë të procedurave, mbrojtësi ose:
 - a. vepron sipas nenit 23(2) dhe pjesës 16 të Direktivës, ose
 - b. në rastet e:
 - (1) paragrafit (3)(b), merr pëlqimin e klientëve të mëparshëm që ka gjasë të kenë pasoja, për të përfaqësuar klientin e pritshëm ose të ri dhe vlerëson nëse një pëlqim i tillë ka gjasa të cenojë në mënyrë të pakthyeshme administrimin e drejtë dhe të duhur të drejtësisë, përfshirë të drejtën e klientit për një gjykim të drejtë. Mbrojtësi dokumenton me shkrim pëlqimin, si edhe vlerësimin e tij. Në rast dyshimi për vlerësimin, mbrojtësi kërkon këshilla nga Organi i Pavarur Përfaqësues i Mbrojtësve të Specializuar. Nëse këshilla bie ndesh me vlerësimin e mbrojtësit, atëherë mbrojtësi njofton panelin apo gjykatësin e caktuar për këtë qëllim, i cili pas këshillimeve me palët përcakton nëse është demonstruar ndonjë mundësi reale për ekzistencën e konfliktit midis detyrës së mëparshme, aktuale ose të pritshme, sipas rastit;

(2) paragrafit (3)(c) dhe (d), mbrojtësi njofton menjëherë panelin apo gjykatësin e caktuar për atë qëllim, i cili pas këshillimeve me palët përcakton nëse është demonstruar ndonjë mundësi reale për ekzistencën e konfliktit midis detyrës së mëparshme dhe aktuale.

5. Në zgjedhjen e anëtarëve të ekipit të vet sipas pjesës 18(1) të Direktivës, mbrojtësi zbaton paragrafin 3 *mutatis mutandis*.
6. Paragrafi 3(a) nuk zbatohet për një mbrojtës viktimash që caktohet për grup viktimash. Mbrojtësi i viktimave i këshillon klientët që në fillim për natyrën e përfaqësimit dhe për çdo konflikt të mundshëm interesash brenda grupit. Mbrojtësi i viktimave përfaqëson interesat e të gjithë klientëve dhe nuk i ofron trajtim favorizues asnjë klienti ndër klientët e përfaqësuar. Mbrojtësi i viktimave mund të kërkojë këshilla nga kreu i Zyrës së Pjesëmarrjes së Viktimave nëse ka arsye të besojë se ekziston një konflikt interesash midis klientëve të vet që ka lidhje me pjesëmarrjen e tyre në procedurat përpara Dhomave të Specializuara.

Neni 29 Marrëdhënie seksuale me klientët

Mbrojtësi nuk:

- a. i kërkon apo e urdhëron një klient të kryejë marrëdhënie seksuale me të apo;
- b. kryen marrëdhënie seksuale me një klient, nëse ka arsye të besohet se një marrëdhënie e tillë seksuale mund të rezultojë në shkelje të këtij Kodi.

KREU IV Detyrimet e prokurorëve

Neni 30 Detyrime të përgjithshme

1. Gjatë paraqitjes së parashtrimeve përpara një paneli, prokurorët flasin gjithnjë në cilësinë e tyre si përfaqësues të Prokurorit të Specializuar.
2. Në hetimin dhe procedimin penal të veprave penale brenda juridiksionit të Dhomave të Specializuara, prokurorët:
 - a. respektojnë plotësisht supozimin e pafajësisë në komentet e tyre publike, apo kur flasin para mediave për themelësinë e çështjeve të caktuara;
 - b. respektojnë dhe garantojnë plotësisht të drejtat e të dyshuarve dhe të të akuzuarve;
 - c. punojnë me efektivitet dhe në përputhje me nevojën për kryerjen e shpejtë të procedurave; dhe
 - d. reagojnë pa vonesa të panevojshme ndaj vendimeve ose urdhrave të një paneli dhe u përgjigjen në kohë mocioneve të palëve të tjera.

Neni 31 Pavarësia dhe paanësia

Në përputhje me nenin 24(2) dhe 35(1) të Ligjit dhe nenin 6, prokurorët garantojnë pavarësinë e Zyrës së Prokurorit të Specializuar:

- a. duke ushtruar funksionet e tyre:

- (1) jashtë çdo ndikimi, nxitjeje, kërcënimi apo ndërhyrjeje të palejueshme; dhe
- (2) pa kërkuar apo marrë udhëzime nga burime të jashtme;
- b. duke udhëzuar punonjësit apo konsulentët e Zyrës së Prokurorit të Specializuar në lidhje me masat që kërkohen për të siguruar një pavarësi të tillë;
- c. duke mos marrë pjesë në asnjë aktivitet që nuk pajtohet me funksionet e tyre apo mandatin e Zyrës së Prokurorit të Specializuar, apo që ka gjasa të ndikojë negativisht tek besimi në pavarësinë dhe integritetin e kësaj zyre; dhe
- d. duke i raportuar Prokurorit të Specializuar pa vonesa të panevojshme çdo përpjekje të kujtdo që i nxit të shkelin detyrimin për pavarësi dhe duke marrë masa për të siguruar që punonjësit t'u raportojnë atyre çdo përpjekje të tillë.

Neni 32 Konflikti i interesave

1. Një prokuror nuk punon për asnjë çështje në Dhomat e Specializuara në të cilën ka marrë pjesë personalisht dhe thelbësisht si mbrojtës apo si anëtar i ekipit të mbrojtësit, si zyrtar i emëruar, punonjës apo në çfarëdo cilësie tjetër.
2. Kur lind një konflikt i tillë i mundshëm interesash, prokurori njofton menjëherë panelin apo gjykatësin e caktuar për atë qëllim i cili pas këshillimeve me palët, përcakton nëse është demonstruar një mundësi reale për ekzistencën e konfliktit midis detyrës së mëparshme dhe aktuale.
3. Paragrafët 1 dhe 2 zbatohen *mutatis mutandis* për çdo punonjës dhe konsulent të Zyrës së Prokurorit të Specializuar, të paemëruar si prokuror.

KREU V Regjimi disiplinor

Pjesa 1 Dispozita të përgjithshme

Neni 33 Kundërvajtjet dhe periudha e parashkrimit

1. Mbrojtësit dhe prokurorët kryejnë kundërvajtje nëse me vetëdije:
 - a. shkelin apo orvaten të shkelin një detyrim thelbësor etik, ose profesional të ngarkuar nga Direktiva, ky Kod, ose Rregullorja e Ndhmës Juridike;
 - b. urdhërojnë ose me vetëdije ndihmojnë apo nxisin një person tjetër të kryejë shkeljen, apo kryejnë shkelje përmes veprimeve të një personi tjetër; ose
 - c. nuk i binden një vendimi disiplinor për sjellje kundërvajtëse sipas këtij Kodi.
2. Procedura disiplinore për sjellje kundërvajtëse sipas këtij neni mund të fillojë vetëm brenda një (1) viti prej sjelljes kundërvajtëse të pretenduar.

Neni 34 Përgjegjësia e mbrojtësit ose prokurorit në pozitë eprore

1. Mbrojtësit apo prokurorët në pozitë eprore të drejtpërdrejtë bëjnë përpjekje të arsyeshme për të siguruar që bashkëmbrojtësit apo prokurorët nën vartësinë e tyre të drejtpërdrejtë dhe persona të tjerë nën vartësinë e tyre të drejtpërdrejtë, t'u përmbahen detyrimeve të tyre sipas këtij Kodi.
2. Mbrojtësit apo prokurorët në pozitë eprore të drejtpërdrejtë janë përgjegjës për shkeljen e këtij Kodi nga bashkëmbrojtësit apo prokurorët nën vartësinë e tyre të drejtpërdrejtë dhe persona të tjerë nën vartësinë e tyre të drejtpërdrejtë, nëse mbrojtësit apo prokurorët:
 - a. urdhërojnë ose, duke pasur njohuri për sjelljen konkrete, miratojnë sjelljen në fjalë; ose
 - b. dinin ose kishin arsye të dinin për sjelljen në kohën kur pasojat e saj mund të ishin shmangur apo zbutur, por nuk ndërmorën masa ndreqëse të arsyeshme.
3. Mbrojtësit apo prokurorët në pozitë eprore të drejtpërdrejtë që veprojnë në përputhje me një zgjidhje të arsyeshme të një çështjeje të detyrës profesionale, nuk janë në shkelje të këtij Kodi.

Neni 35 Përgjegjësia e bashkëmbrojtësit ose prokurorit vartës

1. Bashkëmbrojtësi ose prokurori në vartësi të drejtpërdrejtë është përgjegjës sipas këtij Kodi, pavarësisht se mund të ketë vepruar nën drejtimin e mbrojtësit ose prokurorit në pozitë eprore.
2. Bashkëmbrojtësi ose prokurori në vartësi të drejtpërdrejtë që vepron në përputhje me zgjidhjen e arsyeshme të mbrojtësit ose prokurorit në pozitë eprore të një çështjeje të diskutueshme të detyrës profesionale, nuk është në shkelje të këtij Kodi.
3. Bashkëmbrojtësi ose prokurori në vartësi të drejtpërdrejtë refuzon t'i zbatojë udhëzimet e mbrojtësit ose prokurorit në pozitë eprore, të cilat logjikisht beson se përbëjnë shkelje flagrante të këtij Kodi.

Neni 36 Procedura disiplinore për prokurorët

Në lidhje me çfarëdo ankese ndaj një prokurori për kundërvajtje të pretenduar, në përputhje me nenin 33:

- a. Prokurorët i nënshtrohen procedurës disiplinore të parashikuar në rregullën 81 të Rregullores për Punonjësit, sikurse është ndryshuar me këtë nen. Në qoftë se nuk përcaktohet ndryshe në paragrafin (b), pjesët 2-3 të Kreut V, nuk zbatohen në lidhje me këtë procedurë;
- b. Për procedura disiplinore kundër prokurorëve zbatohen dispozitat e mëposhtme:
 - (1) përkufizimi i parashtruesit të ankesës dhe palës së paditur sipas nenit 2(2);
 - (2) procedura e parashikuar në nenin 37(1)-(3);
 - (3) neni 43 dhe;
- c. anëtarët e Komisionit Këshillimor Disiplinor paraparë në rregullën 81(o)(1) dhe (2) të Rregullores për Punonjësit, janë prokurorë të përzgjedhur nga Prokurori i Specializuar.

Pjesa 2 Procedura disiplinore

Neni 37 Parashtrimi i ankesës

1. Parashtruesi i ankesës mund t'i parashtrojë Administratorit ose Prokurorit të Specializuar një ankesë ndaj një sjelljeje të përcaktuar në nenin 33, sipas rastit me shkrim ose, kur parashtruesi i ankesës nuk është në gjendje ta bëjë këtë, me gojë përpara Administratorit, që e dokumenton ankesën. Ankesa duhet:
 - a. të përcaktojë parashtruesin e ankesës dhe palën e paditur;
 - b. të përfshijë dispozitat ligjore mbi të cilat bazohet, kur është e mundur;
 - c. të përshkruajë me hollësi të mjaftueshme sjelljen kundërvajtëse të pretenduar të palës së paditur; dhe
 - d. të përfshijë të gjitha provat përkatëse ose referencat në lidhje me to.
2. Parashtruesit të ankesës i jepet mundësia ta lexojë vetë dokumentin apo t'ia lexojë dikush, dhe e nënshkruan atë.
3. Ankesa mund të parashtrohet vetëm brenda periudhës së përcaktuar në nenin 33 (2).
4. Administratori i trajton ankesat në mënyrë konfidenciale dhe ia përcjell pa vonesë komisionerit, me përjashtim të rasteve kur ankesa është anonime.
5. Ankesën e parashtruar nga një panel përfshirë edhe ankesat sipas nenit 14(5), Administratori ia përcjell pa vonesë Komisionit Disiplinor në përputhje me nenin 42.

Neni 38 Të drejtat e palës së paditur

1. Pala e paditur gëzon të drejtat e mëposhtme:
 - a. të marrë ndihmë juridike të zgjedhur vetë dhe me shpenzimet e veta;
 - b. të mbajë heshtje dhe të refuzojë të bëjë deklarata që mund të përdoren kundër palës së paditur;
 - c. të marrë të gjitha provat, informacionin dhe letërkëmbimin përkatës në një gjuhë që e kupton;
 - d. t'i jepen kohë dhe mjete të mjaftueshme për të përgatitur mbrojtjen e vet; dhe
 - e. të paraqesë prova dhe të verifikojë të gjitha provat, përfshirë të drejtën për të marrë në pyetje personalisht apo përmes përfaqësuesit të vet ligjor çdo person të thirrur nga Komisioni Disiplinor apo Komisioni i Apelit Disiplinor, për të dëshmuar para këtyre instancave.
2. Pala e paditur merr të gjithë informacionin e mbledhur nga komisioneri si edhe raportin e komisionerit, në përputhje me masat mbrojtëse të miratuara nga Komisioni Disiplinor me kërkesën e komisionerit.

Neni 39 Komisioneri

Komisioneri është një mbrojtës me aftësi të dëshmuara në etikën ligjore profesionale, i përzgjedhur dhe i emëruar nga Administratori për një ankesë të caktuar.

Neni 40 Procedura para komisionerit

1. Me marrjen e një ankese, komisioneri ose:
 - a. e hedh poshtë ankesën menjëherë brenda dy (2) javësh pas marrjes së saj dhe, kur është e zbatueshme, njofton parashtruesin e ankesës për hedhjen poshtë të saj dhe arsyet për të, nëse:
 - (1) ankesa nuk përmbush ndonjë prej kritereve të përcaktuara në nenin 37 (1)-(3);
 - (2) komisioneri e konsideron ankesën qëllimkeqe, të gabuar, të pavlerë, të pabazë, apo të parashtruar jashtë afatit; ose,
 - (3) komisioneri nuk ka juridiksion.

- b. e përfundon procedurën në rast të ndërmjetësimit të suksesshëm të nisur nga komisioneri, parashtruesi i ankesës ose pala e paditur; ose
 - c. nis procedurë disiplinore, duke ia dërguar ankesën palës së paditur, fillon hetimin e sjelljes kundërvajtëse të pretenduar dhe e informon Administratorin për të nisur përzgjedhjen dhe emërimin e anëtarëve të Komisionit Disiplinor sipas nenit 41 (1).
2. Pala e paditur mund të bëjë parashtrime me shkrim brenda njëzet e një (21) ditësh nga data e marrjes së ankesës. Komisioneri mund të zgjasë afatin, por jo më shumë se dy (2) muaj, në qoftë se i tregohen arsye bindëse.
 3. Komisioneri heton pa humbur kohë sjelljen kundërvajtëse të pretenduar të palës së paditur dhe i dërgon një raport Komisionit Disiplinor për rezultatet e hetimit brenda dy (2) muajsh nga marrja e ankesës, ose brenda një (1) muaji nga marrja e parashtrimeve të palës së paditur, sipas rastit. Në raport, komisioneri përcakton faktet përkatëse, shënon konstatimet e veta në lidhje me shkeljet e instrumenteve ligjore përkatëse dhe rekomandon veprime të mëtejshme, përfshirë pushimin e çështjes për mungesë provash të mjaftueshme apo formulimin e akuzave disiplinore.
 4. Në raste të veçanta, kur vepra kundërvajtëse e pretenduar është e një natyre të tillë që cenon rëndë interesat e drejtësisë, komisioneri i kërkon Administratorit të procedojë sipas pjesës 16(3) të Direktivës.
 5. Pala e paditur informon menjëherë Administratorin për çdo procedurë disiplinore të nisur kundër tij ose saj dhe/ose për masën disiplinore kundër tij ose saj marrë nga një instancë tjetër në lidhje me ankesën, përfshirë edhe masat disiplinore sipas nenit 48. Administratori ia dërgon këtë informacion komisionerit, Komisionit Disiplinor, apo Komisionit të Apelit Disiplinor, sipas rastit.

Neni 41 Komisioni disiplinor

1. Komisioni Disiplinor është një panel i pavarur i përbërë nga tre anëtarë të emëruar për shqyrtimin e një ankese konkrete. Administratori përzgjedh dy mbrojtës si anëtarë të Komisionit Disiplinor. Anëtari i tretë përzgjidhet nga autoriteti shtetëror, ose nga shoqata e avokatëve që ka juridiksion mbi aktivitetet e palës së paditur. Kur nuk gjendet një instancë e tillë, ose kur nuk vjen përgjigje brenda një kohe të arsyeshme, përzgjedhja bëhet nga Administratori pas këshillimit me palën e paditur.
2. Në rastin kur një anëtar i Komisionit Disiplinor i dërgon Komisionit Disiplinor njoftim me shkrim për tërheqjen prej detyrës, për shkak të një konflikti aktual apo të mundshëm interesash, ose sepse nuk është i disponueshëm për një periudhë të konsiderueshme dhe Komisioni Disiplinor është i mendimit se administrimi i drejtë dhe i duhur i drejtësisë kërkon vijimin e procedurës disiplinore, ai anëtar zëvendësohet me anë të procedurës së parashikuar në paragrafin 1.
3. Të gjithë anëtarët e Komisionit kanë të njëjtat të drejta dhe vota. Vendimet e Komisionit merren me shumicë të thjeshtë votash.

Neni 42 Procedura para Komisionit Disiplinor

1. Brenda dy (2) muajsh nga marrja e raportit të komisionerit sipas nenit 40(3), Komisioni Disiplinor:
 - a. e pushon çështjen për mungesë juridiksioni;

- b. e pushon çështjen, nëse sipas raportit të komisionerit nuk ka shkaqe të arsyeshme për nxjerrjen e përfundimit se pala e paditur e ka kryer sjelljen kundërvajtëse të pretenduar, nëse është arritur një zgjidhje miqësore, apo nëse ankesa është parashtruar jashtë afatit;
 - c. i kërkon komisionerit të kryejë hetime të mëtejshme; ose
 - d. i konfirmon akuzat disiplinore kundër palës së paditur dhe vendos nëse duhet të mbajë një seancë, apo të kërkojë parashtrime me shkrim nga komisioneri, pala e paditur dhe cilido person tjetër që gjykohet si i nevojshëm për të provuar të vërtetën.
2. Në marrjen e vendimit sipas paragrafit 1, konstatimet e raportit të komisionerit nuk kanë fuqi detyruese mbi Komisionin Disiplinor.
 3. Kur Komisioni Disiplinor, në bazë të provave dhe parashtrimeve të marra vjen në përfundimin se pala e paditur e ka kryer sjelljen kundërvajtëse të pretenduar, atëherë këtë e pasqyron në konstatimin përkatës dhe mund të caktojë masat disiplinore të parapara në nenin 43. Në rast të kundërt, Komisioni Disiplinor hedh poshtë çdo akuzë.
 4. Nëse mbahet një seancë disiplinore, ajo duhet të jetë publike, përveçse kur Komisioni Disiplinor urdhëron ndryshe.
 5. Vendimi i Komisionit Disiplinor sipas paragrafit 3 është i arsyetuar dhe mund të përfshijë mendime të veçanta apo mospajtuese.
 6. Komisioni Disiplinor informon me shkrim parashtruesin e ankesës, palën e paditur dhe komisionerin për vendimin e vet sipas paragrafit 3, duke e bërë publik për aq sa është e mundur, por pa nxjerrë identitetin e parashtruesit të ankesës.
 7. Me përfundimin e procedurës disiplinore, Administratori informon organin përkatës shtetëror të palës së paditur për vendimin e Komisionit Disiplinor, përveçse nëse apelohej sipas nenit 46.
 8. Pas tejkalimit të afatit kohor për apelim në përputhje me nenin 46, vendimi i Komisionit Disiplinor konsiderohet i formës së prerë.

Neni 43 Masat disiplinore

1. Në qoftë se konstatohet sjellje kundërvajtëse, Komisioni Disiplinor mund të caktojë një nga masat disiplinore të mëposhtme:
 - a. vërejtje;
 - b. qortim publik me shënim në dosjen personale të mbrojtësit ose prokurorit, që mbahet nga njësia përkatëse e Dhomave të Specializuara ose e Zyrës së Prokurorit të Specializuar;
 - c. dënim me gjobë deri në 2.000 euro;
 - d. kthim nga mbrojtësi të honorarëve Zyrës Administrative ose klientit, sipas rastit, deri në 15.000 euro, pa paragjykim ndaj kompensimit sipas Rregullores së Ndhmës Juridike, nëse është e zbatueshme;
 - e. pezullim të së drejtës së mbrojtësit për ushtrimin e profesionit para Dhomave të Specializuara për një periudhë jo më shumë se dy (2) vjet, duke aktivizuar procedurën e përcaktuar në pjesën 16 të Direktivës;
 - f. ndalim të përhershëm të ushtrimit të profesionit si mbrojtës para Dhomave të Specializuara dhe, nëse është e zbatueshme, përjashtim nga Lista e Mbrojtësve, duke aktivizuar procedurën e përcaktuar në pjesën 16 të Direktivës dhe;

- g. referim drejtuar Administratorit të një konstatimi të sjelljes kundërvajtëse të një punonjësi, për procedurën e përshtatshme sipas Rregullores për Punonjësit.
2. Nëse kundër palës së paditur merret masë disiplinore, atëherë pala e paditur paguan shpenzimet administrative të procedurës disiplinore përcaktuar nga Administratori, si edhe shpenzimet e përfaqësimit të vet juridik.
 3. Nëse akuzat apo ankesa rrëzohen, parashtruesi i ankesës paguan shpenzimet administrative të procedurës disiplinore dhe shpenzimet e përfaqësimit juridik të palës së paditur, nëse ka.
 4. Nëse procedura përfundon për arsye të tjera, Dhoma e Specializuarë paguan të gjitha tarifat administrative të procedurës, me përjashtim të honorarëve që lidhen me të drejtën për ndihmë juridike.

Neni 44 Tërheqja e ankesës

1. Në çdo kohë gjatë procedurës, parashtruesi i ankesës mund ta tërheqë ankesën duke i dërguar komisionerit njoftim me shkrim. Çdo ankesë e mëvonshme për të njëjtën lëndë nga i njëjti parashtrues mund të paraqitet vetëm në rast të zbulimit të fakteve të reja të cilat nuk dihen nga parashtruesi i ankesës në kohën e ankesës së parë.
2. Nëse parashtruesi i ankesës e tërheq kërkesën, procedura disiplinore sipas nenit 40 konsiderohet e mbyllur, përveçse kur brenda një (1) muaji nga tërheqja:
 - a. me miratimin e Administratorit, komisioneri vendos *proprio motu* të vazhdojë apo të nisë një procedurë sipas nenit 40; ose
 - b. Komisioni Disiplinor me miratimin e Administratorit, apo Komisioni i Apelit Disiplinor me miratimin e Administratorit dhe të Kryetarit, vendos ta vazhdojë procedurën pas dëgjimit të komisionerit dhe palës së paditur.

Neni 45 Komisioni i Apelit Disiplinor

1. Komisioni i Apelit Disiplinor është një panel i pavarur i përbërë prej tre anëtarësh. Për një apel të caktuar, Administratori përzgjedh dhe emëron dy mbrojtës me aftësi të dëshmuara në etikën ligjore profesionale. Kryetari cakton një gjykatës nga Regjistri i Gjykatësve Ndërkombëtarë për një apel të tillë.
2. Gjykatësi i caktuar vepron si Kryetar i Komisionit të Apelit Disiplinor.
3. Neni 41(2)-(3) zbatohet *mutatis mutandis* për Komisionin e Apelit Disiplinor.

Neni 46 Procedura para Komisionit të Apelit Disiplinor

1. Komisionit të Apelit Disiplinor mund t'i parashtrohen apele për shkaqe të një gabimi të dukshëm fakti apo ligjor.
2. Apelet mund të parashtrohen brenda një (1) muaji nga njoftimi i vendimit të Komisionit Disiplinor:
 - a. nga pala e paditur kur Komisioni Disiplinor ka përcaktuar se janë provuar një apo më shumë akuza për kundërvajtje; ose
 - b. nga komisioneri.
3. Brenda dy (2) ditësh pune nga marrja e apelit, Komisioni i Apelit Disiplinor i përcjell apelin komisionerit, palës së paditur apo parashtruesit të ankesës, sipas rastit, me afat njëzet e një (21) ditë për t'u përgjigjur.

4. Komisioni i Apelit Disiplinor mund ta hedhë poshtë një apel për mungesë juridiksioni, për mangësi thelbësore, apo kur është parashtruar jashtë afatit.
5. Neni 38 dhe neni 43 zbatohen *mutatis mutandis* për procedurën përpara Komisionit të Apelit Disiplinor.
6. Gjatë rishikimit të tij, Komisioni i Apelit Disiplinor nuk merr apo shqyrton dëshmi që nuk i janë paraqitur Komisionit Disiplinor, përveçse kur nuk kanë qenë të disponueshme në kohën e procedurave përpara Komisionit Disiplinor dhe nuk mund të ishin zbuluar me gjithë ushtrimin e zellit të duhur. Kur kërkohet paraqitja e dëshmive dhe/ose kur mbahet një seancë, dispozitat përkatëse të kësaj pjese zbatohen *mutatis mutandis*.
7. Komisioni i Apelit Disiplinor mund të lërë në fuqi, ndryshojë apo të prapësojë vendimin apo masat disiplinore në apel. Nëse vendimi apo masa disiplinore është apeluar vetëm nga pala e paditur, atëherë vendimi apo masa përkatëse nuk mund të ndryshohet në dëm të palës së paditur. Vendimi i Komisionit të Apelit Disiplinor arsyetohet dhe mund të përfshijë mendime të veçanta apo mospajtuese.
8. Komisioni i Apelit Disiplinor informon me shkrim parashtruesin e ankesës, palën e paditur dhe komisionerin për vendimin e vet, i cili bëhet publik për aq sa është e mundur, por pa nxjerrë identitetin e parashtruesit të ankesës.
9. Me përfundimin e procedurës disiplinore të apelit, Administratori informon organin shtetëror përkatës të palës së paditur për vendimin e Komisionit të Apelit Disiplinor.

Neni 47 Vendim i formës së prerë

Vendimi i Komisionit të Apelit Disiplinor është i formës së prerë.

Pjesa 3 Dispozita përmbyllëse

Neni 48 Marrëdhënia me regjime të tjera disiplinore

1. Kreu aktual nuk paragjykon kompetencat disiplinore të ndonjë autoriteti tjetër që mund të zbatohen për mbrojtësit.
2. Kur komisioneri nis procedura disiplinore kundër një mbrojtësi, në përputhje me nenin 40(1)(c), komisioneri informon autoritetin shtetëror të mbrojtësit pa vonesë dhe i kërkon ta informojë brenda një (1) muaji nëse do të nisë procedurë disiplinore. Nëse autoriteti shtetëror synon, apo ndërkohë ka nisur një procedurë disiplinore në lidhje me të njëjtat veprime dhe sjellje që parashtrohen në ankesë, procedura para komisionerit si edhe afati i parashkrimit paraparë në nenin 33(2), pezullohen në pritje të vendimit të formës së prerë të autoritetit shtetëror, përveçse kur:
 - a. autoriteti shtetëror nuk u përgjigjet komunikimeve dhe konsultimeve të komisionerit brenda një kohe të arsyeshme;
 - b. duket se autoriteti shtetëror nuk është në gjendje, apo nuk është i gatshëm ta përfundojë procedurën disiplinore.
3. Sapo të ketë marrë vendimin e formës së prerë të autoritetit shtetëror, komisioneri informon Komisionin Disiplinor që e deklaron procedurën të mbyllur, përveçse kur vendimi i marrë nuk i jep zgjidhje të kënaqshme ankesës për kundërvajtje sipas këtij Kodi, rast në të cilin Komisioni Disiplinor mund ta udhëzojë komisionerin të rinisë hetimin dhe procedurën e mundshme disiplinore sipas këtij Kodi.
4. Asnjë mbrojtës nuk i nënshtrohet procedurës dhe masave disiplinore sipas këtij Kodi më shumë se një herë për të njëjtin veprim(veprime) dhe/ose mosveprim (mosveprime).

Neni 49 Dokumentimi i procedurave

1. Në rast se nuk parashihet ndryshe, të gjitha parashtrimet, vendimet dhe urdhrat në lidhje me procedurat disiplinore parashtrihen në mënyrë konfidenciale në një nga gjuhët zyrtare të Dhomave të Specializuara.
2. Zyra Administrative administron të gjitha dokumentet e procedurave disiplinore. Ato janë konfidenciale dhe pjesë e arkivave të Zyrës Administrative.

Hagë, Holandë
1 mars 2019

Dr. Fidelma Donlon
Administratore